

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

04 Maj 2017

Seminar me temë: Rezultatet dhe Konkluzionet e Projektit: “Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të transportit rrethqytetas në Bashkinë e Durrësit”



Në kuadër të fushatave të informimit të konsumatorëve, me datë 4 Maj 2017, Qendra “Konsumatori Shqiptar” mbështetur nga Lëviz Albania, organizoi pranë mjediseve të FASTIP një seminar në lidhje me rezultatet dhe konkluzionet e projektit “Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të transportit rrethqytetas në Bashkinë e Durrësit”.



Aktiviteti pati një karakter kryesisht informues për studentët në lidhje me gjetjet e këtij monitorimi si dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me të drejtat që ata kanë si pasagjerë- konsumatorë.



Studentët pjesëmarrës shfaqën shumë interes edhe për rezultatet e këtij monitorimi të bere më kontributin e studentëve të tjrë të UAMD-së, por edhe për prezantimin e të drejtave të tyre si udhëtarë dhe përdorues të transportit publik rrethqytetas. Përfaqësuesit e Qendrës “Konsumatori Shqiptar” gjithashtu shpërndanë për studentët disa fletëpalosje ku shpreheshin qartë të drejtat e konsumatorëve në lidhje me transportin publik.

